**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE VLORË**

**NOTER DARIEN N. KURTI**
**ADRESA CLIRIMI**
**TEL: 682019929**

# KONTRATA TË TJERA

## (SHTESË KONTRATE)

**Nr. repertori: 5054** **Nr. koleksioni: 2157**

**Corovode më 26/08/2024**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

A2024062660250117658

A202408266025017658

**AMENDIM I KONTRATËS SË SHITJES SË PASURISË SË LUAJTSHME**

**(KUOTA KAPITALI)**

**Nr. 3957 Rep., Nr. 1698 Kol., Datë 07/08/2024**

Sot, më datë 26.08.2024 para meje Noter DARIEN N. KURTI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore VLORË, me zyrë në adresën Corovode, CLIRIMI, u paraqit personalisht:

**PALA SHITËSE:**
Shoqëria THURJE, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M11327009B, me adresë Nr.Pasurie 665/14, Nr.Pasurie 665/6, Zone Kadastrale 1549, përfaqësuar nga Administratori Esat Demiri, atësia Shaqir, amësia Mendie, shtetas Shqiptar, lindur në Fushë-Lurë, Dibër dhe banues në Kamëz, me adresë Lagje 4,Rr."berisha"; Nd. 002; Kamëz; Kamëz; 1054; Kamëz, lindur më 11/01/1978, gjendja civile "i divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036821999 dhe nr. personal H80111070H.
***(në cilësinë e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "Thurje" sh.p.k)***

**PALA BLERËSE**:
Shoqëria SHKODRA BETON-INERT, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L72025009M, me adresë Autostrada Tirane-Durres Km 0, Ish-Serrat, Mezez, përfaqësuar nga Administratori Mukadez Gjini, atësia Vehbi, amësia Lumbije, shtetase Shqiptare, lindur në Shkodër dhe banuese në Shkodër, me adresë Vojo Kushi; Nd. 036; H. 00; Ap. 000; Shkodër; Shkodër; 4001; Shkodër, lindur më 04/08/1960, gjendja civile "e ve", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035248679 dhe nr. personal G05804067U, përfaqësuar me prokurë të përgjithshme me Nr. 930 Rep., Nr. 394 Kol, Datë 28/03/2023, Notere Violeta Sulkaj nga Z. **Leonard Sulaj**, i biri i Reis-it dhe Rakibe, shtetas shqiptar, lindur në Kuç, Vlorë dhe banues në Tiranë me adresë Seit Teqja 03950073; Nd. 15; H.1; Petrelë; Mullet; 1034; Tiranë, lindur më 16/04/1969, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me leternjoftim id Nr. 035843393 i regjistruar me numër personal **G90416175F.**

***(këtu e më poshtë për efekt të kësaj kontrate, referuar si palë blerëse).***

Shtetasit e paraqitur janë madhorë, me zotësi të plotë juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, të cilët me vullnet të lirë, të plotë e të pavesuar, kërkuan lidhjen e kësaj kontrate sipërmarrje, si më poshtë vijon:

**Baza Ligjore**

Neni 705 i Kodit Civil

Neni 659 e vijues të Kodit Civil

Neni 62, gërma "ll", neni 63, pika 1, gërma "ç", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "*Për Noterinë*"

**NENI 1**

**OBJEKTI I KONTRATËS**

Palët e mësipërme në dakortësi me njëra tjetrën, kanë nënshkruar Kontratën e Shitjes Pasuri e Luajtshme (Kuota Kapitali) me Nr. 3957 Rep., me Nr. 1698 Kol., datë 07/08/2024., Noter Darien N. Kurti.

A20240626602501176S8

Në dakortësi me njëri tjetrin kanë vendosur amendimin e pikës 2.2 të Nenit 2 të kontratës **Cmimi dhe Mënyra e Pagesës** dhe amendimin e pikës 3.1 të Nenit 3 **Transferimi i Kapitalit** dhe amendimin e pikës 3.4 të Nenit 3 **Transferimi i Kapitalit.**

**NENI 2**

**PËRMBAJTJA E KONTRATËS**

**2.1 Kontratën e Shitjes Pasuri e Luajtshme (Kuota Kapitali) me Nr. 3957 Rep., me Nr. 1698 Kol., datë 07/08/2024., parashikohet:**

***Neni 2* (Cmimi dhe Mënyra e Pagesës) *pika 2.2:***

**ISHTE:**

**2.2** Pagesa që përfaqëson çmimin e shitjes, objekt i kësaj kontrate likujdohet menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate pranë bankës Tirana Bank.

**BËHET:**

**2.2** Pagesa që përfaqëson çmimin e shitjes, objekt i kësaj kontrate do të likujdohet nga pala blerëse pranë bankës Tirana Bank., pas një periudhe 1.5 vjeçare (një pikë pesë vjecare), nga data e nënshkrimit të këtij amendimi.

***Neni 3* (Transferimi i Kapitalit) *pika 3.1:***

**ISHTE:**

**3.1** E drejta e pronësisë mbi kuotat që shiten, që pala shitëse zotëron, i kalon palës blerëse pas nënshkrimit të kontratës dhe kryerjes së pagesës së çmimit të shitjes.

**BËHET:**

**3.1** E drejta e pronësisë mbi kuotat që shiten, që pala shitëse zotëron, i kalon palës blerëse menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate.

***Neni 3* (Transferimi i Kapitalit) *pika 3.4:***

**ISHTE:**

**3.4** Mandati bankar i likujdimit të çmimit të shitjes, është provë e plotë e likujdimit të çmimit të shitjes dhe bashkë me një kopje të kontratës do të depozitohen në QKB me qëllim kalimin e pronësisë së kuotave në favor të palës blerëse sipas kushteve të dakortësuara.

**BËHET:**

**3.4** Mandati bankar i likujdimit të çmimit të shitjes, do t'i bashkëlidhet kontratës në momentin e likujdimit të çmimit të shitjes, sipas afatit 1.5 vjeçar, të specifikuar në këtë kontratë. Titulli i pronësisë së kuotave të kapitalit i kalon palës blerëse menjëherë me nënshkrimin e këtij amendimi dhe regjistrimin e kontratës në QKB.

**NENI 3**

**TË PËRGJITHSHME**

**3.1** Palët, që nënshkruajnë këtë amendim kontrate bien dakord që çdo mosmarrëveshje që mund të lindë, ta zgjidhin me mirëkuptim ndërmjet tyre dhe nese nuk zgjidhen me mirëkuptim, t'i drejtohen për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**3.2** Njoftimet për çdo rast do të bëhen në adresat respektive të palëve të përshkruara në kontratë.

**NENI 4**

**PJESË PËRBËSE TË KONTRATËS**

**4.1** Bashkëlidhur kësaj kontrate ndodhen:

A20240826860250117858

Kontrata e shitjes së pasurisë së luajtshme (kuota kapitali) nr. 3957 rep., nr. 1698 kol., datë 07/08/2024; Ekstrakti i shoqërive, Dokumenta të identifikimit të palëve.

**NENI 5**

**INTERPRETIMI I AMENDIM KONTRATËS NË TËRËSI**

5.1 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë Kontratë.

**NENI 6**
**GJUHA E HARTIMIT TË AMENDIM KONTRATËS**

6.1 Amendim Kontrata u redaktua në gjuhën shqipe prej meje noteres mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të palëve kontraktuese.

**Dispozitat Përfundimtare**

Kontrata e kalimit të të drejtave, u lexua nga unë Noteri/ja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterit.

Unë Noteri, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri/ja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**PALËT**

| PALA SHITËSE: | PALA BLERËSE: |
| --- | --- |
| **Shoqëria THURJE sh.p.k** | **Shoqëria Shkodra Beton Inert sh.p.k** |
| Përfaqësuar nga Administratori | Përfaqësues me prokurë |
| **Esat Demiri** | **Leonard Sulaj** |

**NOTER**

DARIEN N. KURTI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE VLORË

NOTER DARIEN N. KURTI
ADRESA CLIRIMI
TEL: 682019929

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 3957** **Nr. koleksioni: 1698**

**Corovode më 07/08/2024**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

A20240626602000991339

## KONTRATË SHITJE KUOTASH TË KAPITALIT TË SHOQËRISË TREGTARE "THURJE SH.P.K"

Sot, më datë 07.08.2024, para meje Noter DARIEN N. KURTI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore VLORË, me zyrë në adresën Corovode, CLIRIMI, u paraqit personalisht:

**SHITES**:Shoqëria THURJE, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M11327009B, me adresë Nr.Pasurie 665/14, Nr.Pasurie 665/6, Zone Kadastrale 1549,përfaqësuar nga Administratori Esat Demiri si ortak i vetem i shoqerise, atësia Shaqir, amësia Mendie, shtetas Shqiptar, lindur në Fushë-Lurë, Dibër dhe banues në Kamëz, me adresë Lagje 4,Rr."berisha"; Nd. 002; Kamëz; Kamëz; 1054; Kamëz, lindur më 11/01/1978, gjendja civile "i divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036821999 dhe nr. personal H80111070H

**BLERES**:Shoqëria SHKODRA BETON-INERT, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L72025009M, me adresë Autostrada Tirane-Durres Km 0, Ish-Serrat, Mezez, përfaqësuar nga Administratori Mukadez Gjini, atësia Vehbi, amësia Lumbije, shtetase Shqiptare, lindur në Shkodër dhe banuese në Shkodër, me adresë Vojo Kushi; Nd. 036; H. 00; Ap. 000; Shkodër; Shkodër; 4001; Shkodër, lindur më 04/08/1960, gjendja civile "e ve", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me Leternjoftim ID nr. 035248679 dhe nr. personal G05804067U, përfaqësuar me prokurë të tipit "Prokure e pergjithshme" me Nr. Rep 930, Nr. kol 394, në datë 28/03/2023, hartuar nga Violeta Sulkaj,nga Leonard Sulaj, atësia Reis, amësia Rakibe, shtetas Shqiptar, lindur në Kuç, Vlorë dhe banues në TIRANË, me adresë Seit Teqja 03950073; Nd. 15; H. 1; Petrelë; Mullet; 1034; Tiranë, lindur më 16/04/1969, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035843393 dhe nr. personal G90416175F,

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noteri redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë , sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

### PALËT KONTRAKTUESE
### PALA SHITËSE

Shoqëria THURJE, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M11327009B, me adresë Nr.Pasurie 665/14, Nr.Pasurie 665/6, Zone Kadastrale 1549,përfaqësuar nga Administratori Esat Demiri si ortak i vetem i shoqerise, atësia Shaqir, amësia Mendie, shtetas Shqiptar, lindur në Fushë-Lurë, Dibër dhe banues në Kamëz, me adresë Lagje 4,Rr."berisha"; Nd. 002; Kamëz; Kamëz; 1054; Kamëz, lindur më 11/01/1978, gjendja civile "i divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036821999 dhe nr. personal H80111070H. *(në cilësinë e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "Thurje" sh.p.k).*

### PALA BLERËSE

**Shoqëria"Shkodra Beton Inert" Sh.p.k.**, identifikuar me NIPT L72025009M, me seli në adresën: KasharMëzez Autostrada Tiranë -Durrës km 0, ish Serrat,Mëzez, përfaqësuar ligjërisht nga Administratori **Znj. Mukadez Gjini** e bija e Vehbi dhe Olimbi, e datëlindjes 04-08

-1960, lindur në Shkodër, banuese në Shkodër, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, statusi civil "e ve", identifikuar nëpërmjet/leternjoftimit, e, regjistruar, me numer personal **G05804067U**, përfaqësuar me prokurë të tipit "Prokure e pergjithshme" me Nr. Rep 930, Nr. kol 394, në datë 28/03/2023, hartuar nga Violeta Sulkaj,nga Leonard Sulaj atësia Reis, amësia Rakibe, shtetas Shqiptar, lindur në Kuç, Vlorë dhe banues në TIRANË, me adresë Seit Teqja 03950073; Nd. 15; H. 1; Petrelë; Mullet; 1034; Tiranë, lindur më 16/04/1969, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035843393 dhe nr. personal G90416175F***(këtu e më poshtë për efekt të kësaj kontrate, referuar si palë blerëse)***.

Shtetasit e paraqitur janë madhorë, me zotësi të plotë juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, të cilët me vullnet të lirë, të plotë dhe të pavesuar kërkuan hartimin e kësaj kontratë shitje kuotash kapitali, si më poshtë vijon:

**BAZA LIGJORE**

Baza ligjore e lidhjes së kësaj kontrates është:
- Neni 705 e vijues të Kodit Civil në fuqi;
- Ligji Nr. 9901 Datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar;
- Ligji Nr. 110/2018, Datë 20.12.2018 "Për Noterinë";
- Ligji Nr. 9887, Datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të Dhënave Personale".

**PËRMBAJTJA E KONTRATËS**

**NENI 1**

**OBJEKTI I KONTRATËS**

1.1 **Esat Demiri**, në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë "Thurje" sh.p.k, është zotërues i 1,00 pjesë të kapitalit themeltar të shoqërisë, me pjesëmarrje në përqindje 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar, e barabartë me 100.000,00 lekë (njëqind mijë); shoqëri e cila është themeluar më datë 22.01.2021, me numër Nipt-i (NUIS) M11327009B, me seli në adresën Tiranë Dritas Nr. Pasurie 665/14, Nr.Pasurie 665/6, Zona Kadastrale 1549, e cila ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar.

1.2 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000,00 LEK (njëqindmijë lekë).

1.3 Pala shitëse dëshiron t'i shesë palës blerëse Shoqërisë **"Shkodra Beton Inert" Sh.p.k** 100 % të kapitalit, me vlerë 100.000,00 lekë (njëqindmijë), pra të gjithë pjesën takuese që ai zotëron në kapitalin e shoqërisë Thurje sh.p.k, duke u larguar si ortak i vetëm nga shoqëria.

1.4 Pala blerëse shoqëria **Shkodra Beton Inert" sh.p.k** me blerjen e plotë të kuotës së kapitalit, bëhet zotëruese e 100 % të kapitalit të shoqërisë "Thurje" sh.p.k.

**NENI 2**

**ÇMIMI DHE MËNYRA E PAGESËS**

**2.1** Pala shitëse, i shet palës blerëse **"Shkodra Beton Inert" Sh.p.k"** pjesën e vet prej 100 %, kundrejt çmimit të dakortësuar në vlerën 200 000 EUR (dyqind mijë euro).

**2.2** Pagesa që përfaqëson çmimin e shitjes, objekt i kësaj kontrate likuidohet menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate pranë bankës Tirana Bank.

**NENI 3**

**TRANSFERIMI KAPITALIT**

**3.1** E drejta e pronësisë mbi kuotat që shiten, që pala shitëse zotëron, i kalon palës blerëse pas nënshkrimit të kontratës dhe kryerejs së pagesës së cmimit të shitjes.

**3.2** Shitësi i dorëzon blerësit të gjitha dokumentat, deklaratat, ose certifikatat e nevojshme për

përfundimin e transferimit të kapitalit themeltar në favor të bleresit dhe për regjistrimin e këtij transferimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

**3.3** Në momentin e transferimit tek pala bleresë, **Shoqëria Shkodra Beton-Inert" Sh.p.k** bëhet konkretisht zotëruese e 100 % të kapitalit në shoqërinë "Thurje" sh.p.k, kurse pala shitëse largohet si ortak i vetëm i shoqërisë, duke humbur çdo të drejtë që zotëron deri në nënshkrimin e kësaj kontrate.

**3.4** Mandat bankar i likuidimit të cmimit të shitjes, është provë e plotë e likuidimit të cmimit të shitjes dhe bashkë me një kopje të kontratës do të depozitohen në QKB me qëllim kalimin e pronësisë së kuotave në favor të palës blerëse sipas kushteve të dakortësuara.

**NENI 4**
**DEKLARATA DHE GARANCI**

**4.1** Pala shitëse deklaron dhe garanton palën blerëse për sa më poshtë vijon:
**4.2** Pala shitëse deklaron që është pronare e ligjshme e pjesëve që blihen nga pala blerëse, sikurse është dakortësuar ndërmjet tyre, pa asnjë pretendim në të ardhmen;
**4.3** Shoqëria ka dorëzuar të gjitha deklarimet e raportimet e tatimeve që kërkohen të dorëzohen sipas ligjit dhe ka paguar të gjitha vlerësimet tatimore, tarifat dhe detyrime të tjera shtetërore për shoqërinë, pasurinë e të ardhurat e saj, që sipas ligjit janë të detyrueshme për t'u paguar;
**4.4** Shoqëria nuk është në shkelje të ndonjë marrëveshjeje me të cilën është palë;
**4.5** Shoqëria nuk është palë, as nuk është në dijeni të ndonjë rreziku për ndjekje gjyqësore, arbitrazhi, apo administrative, rezultati i së cilës mund të kishte efekt material negativ për blerjen e pjesëve të kapitalit themeltar.

**NENI 5**
**DETYRIMET TATIMORE**

**5.1** Pala blerëse blen kapitalin që pala shitëse zotëron në shoqëri prej 100 % të kapitalit themeltar që pala shitëse zotëron në shoqëri me gjendjen e aktivit dhe pasivit të bilancit të shoqërisë deri në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate.

**NENI 6**
**KUSHTE TË PËRGJITHSHME**

**6.1** Kjo kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar.
**6.2** Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve në lidhje me këtë kontratë, ose çdo marrëveshje tjetër, ose dokument të zbatuar midis palëve për zbatimin e kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve, përndryshe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
**6.3** Kjo kontratë përbën marrëveshjen e plotë midis palëve, në lidhje me çështjet që trajton dhe zëvëndëson çdo marrëveshje të mëparshme, qoftë me gojë apo me shkrim, midis palëve.
**6.4** Pavlefshmëria ose pabazueshmëria e njërës nga dispozitat e kësaj kontrate nuk do të cënojë vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e dispozitave të tjera. Dispozita e pavlefshme do të zëvëndësohet me një marrëveshje ligjërisht të vlefshme, që korrespondon sa më shumë të jetë e mundur me synimet e palëve.

**NENI 7**

**NJOFTIMET**

**7.1** Të gjitha njoftimet dhe komunikime mes palëve do të bëhen me shkrim në adresat e emailit të vëna në dispozicion ndërmjet palëve.

**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

13.1 Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterit.

13.2 Unë Noteri, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

13.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**PALËT KONTRAKTUESE**

**PALA SHITËSE**
Shoqëria THURJE

Administratori Esat Demiri

**PALA BLERËSE**
**"Shoqëria "Shkodra Beton Inert" Sh.p.k., përfaqësues me prokurë**
Leonard Sulaj

**Noter**
DARIEN N. KURTI

VENDIM
I
ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË

Sot më datë __/08/2024 (dymijë e njëzet e katër), unë ortaku i vetëm i shoqërisë **"THURJE" sh.p.k**, e regjistruar si person juridik, me seli të aktivitetit në adresën "Tiranë Dritas Nr. Pasurie 665/14, Nr.Pasurie 665/6, Zona Kadastrale 1549", me NIPT M11327009B, i quajturi **Z. Esat Demiri**, i biri i Shaqir dhe Mendije, shtetas shqiptar, i datëlindjes 11.01.1978, lindur në Fushë Lurë, banues ne Kamëz, në adresën "Lagjja nr. 4, Rr. Berisha, Nd. 002, Kamëz", madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nepërmjet dokumentit identifikues me nr. 036821999, i regjistruar me numër personal **H80111070H;**

i cili vendosi në zbatim dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 9901, Datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligjin për Q.K.R si dhe vendosi të zhvillojë mbledhjen e Asamblesë së Ortakut të vetëm sipas rendit të ditës:

**RENDI I DITËS:**

Unë ortaku i vetëm i shoqërisë Thurje sh.p.k deklaroj se kam vendosur t'i shes 100% të kuotave të kapitalit, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që mbart kompania, shoqërisë Shkodra Beton Inert sh.p.k kundrejt çmimit të dakortësuar në vlerën 200 000 EUR (dyqind mijë euro).

1. Me shitjen e 100 % të kuotave të kapitalit, Shoqëria "Shkodra Beton Inert" sh.p.k bëhet zotëruese e kuotës së plotë të kapitalit, e çdo të drejte dhe detyrimi dhe unë shtetasi Esat Demiri humbas çdo të drejtë që zotëroj deri më tani si ortak i vetëm i shoqërisë.

**VENDOSA:**

Shitjen e 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë Thurje sh.p.k, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e saj, kundrejt çmimit të dakortësuar në vlerën 200 000 EUR (dyqind mijë euro), shoqërisë Shkodra Beton Inert sh.p.k.

M11327009B THURJE Tirane - Albania

**ORTAKU I VETËM**
**SHOQËRISË THURJE SH.P.K**
**ESAT DEMIRI**

SHKODRA BETON
INERT

# VENDIM
# I
# ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË SHKODRA BETON INERT SH.P.K

Sot më datë __/08/2024 (dymijë e njëzet e katër), unë ortaku i vetëm i shoqërisë **"Shkodra Beton Inert" sh.p.k.**, e regjistruar si person juridik, me seli të aktivitetit në adresën Kashar Mëzez Autostrada Tiranë -Durrës km 0, ish Serrat, me NIPT L72025009M, e quajtura **Mukadez Gjini**, e bija e Vehbi dhe Olimbi, e datëlindjes 04-08-1960, lindur në Shkodër, banuese në Shkodër, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, statusi civil "e ve", identifikuar nëpërmjet letemjoftimit, e regjistruar me numër personal **G05804067U**, e përfaqësuar me prokurë të tipit "Prokure e pergjithshme" me Nr. Rep 930, Nr. kol 394, në datë 28/03/2023, hartuar nga Violeta Sulkaj,nga Leonard Sulaj, atësia Reis, amësia Rakibe, shtetas Shqiptar, lindur në Kuç, Vlorë dhe banues në TIRANË, me adresë Seit Teqja 03950073; Nd. 15; H. 1; Petrelë; Mullet; 1034; Tiranë, lindur më 16/04/1969, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letemjoftim ID nr. 035843393 dhe nr. personal G90416175F,

e cila vendosi në zbatim dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 9901, Datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligjin për Q.K.R si dhe vendosi të zhvillojë mbledhjen e Asamblesë së Ortakut të vetëm sipas rendit të ditës:

## RENDI I DITËS:

Unë ortakja e vetme e shoqërisë deklaroj se kam vendosur të blejë kapitalin e plotë të shoqërisë Thurje sh.p.k, në pronësi të Z. Esat Demiri, me 100% të kuotave të kapitalit, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e saj, kundrejt çmimit të dakortësuar në vlerën 200 000 EUR (dyqind mijë euro).

1. Me blerjen e kuotave të plota nga Z. Esat Demiri, Shoqëria "Shkodra Beton Inert" sh.p.k bëhet zotëruese e 100 % të kapitalit të shoqërisë.
2. Të drejtën për nënshkrimin e kontratës së shitjes së kuotave e gëzon përfaqësuesi, Z. Kreshnik Çupi si dhe ndjekjen e të gjithë procedurave për regjistrimin pranë QKB-së, nga përfaqësuesi ose nga individë të emëruar prej tij.

**VENDOSA**

1. Blerjen e kapitalit të plotë të shoqërisë Thurje sh.p.k, në pronësi të Z. Esat Demiri, me 100% të kuotave të kapitalit, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e saj, kundrejt çmimit të dakortësuar në vlerën 200 000 EUR (dyqind mijë euro).

2. Të drejtën për nënshkrimin e kontratës së shitjes së kuotave e gëzon përfaqësuesi, Z. Kreshnik Çupi si dhe ndjekjen e të gjithë procedurave për regjistrimin pranë QKB-së, nga përfaqësuesi ose nga individë të emëruar prej tij.

**SHOQËRIA SHKODRA BETON INERT**

**MUKADEZ GJINI**

**Përfaqësuar nga Leonard Gjini**

RBS

Regjistri i Barreve Sigurues


Rr. e Dones, Qendra e Biznesit Observator
[illegible]
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX: 355 4 2420026
TEL 355 4 2420008
Email: rbs@[illegible].com


# REZULTATET E KERKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te kerkimit: | D-20240805151704044 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 05.08.2024 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 15:17:04 |
| **Lloji i Kerkimit:** | **Emri i Personit Fizik** |
| Numri i Dokumentit: | D-400-698-369 |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI: 0**

**ESAT SHAQIR DEMIRI**

Fundi i Rezultatit te Kerkimit

Fundi i Dokumentit

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE
R.B.S.
TIRANE - ALBANIA

Rigersa Çalliku

RBS

Regjistri i Barreve Sigurese

TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX: 355 4 2420006
TEL: 355 4 2420006

# REZULTATET E KERKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te kerkimit: | D-20240805151704044 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 05.08.2024 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 15:17:04 |
| **Lloji i Kerkimit:** | **Emri i Personit Juridik** |
| Numri i Dokumentit: | D-400-698-369 |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI: 0**

**THURJE SH.P.K.**

Fundi i Rezultatit te Kerkimit

Fundi i Dokumentit

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANE - ALBANIA

**SUBJEKTI KERKUES:**

Emertimi
DARIEN NIKOLIN KURTI P.F.

Rigersa Calliku

**TE DHENAT E PERDORUESIT:**

Emri dhe Mbiemri
RIGERSA CALLIKU

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER VIOLETA V. SULKAJ**
**ADRESA LAGJIA NR.5, RR. SULEJMAN DELVINA, GODINA NR.29, APARTAMENTI NR. 92, HYRJA NR. 15**
**TEL: 0682064889**

# PROKURË E PËRGJITHSHME

**Nr. repertori: 930** **Nr. koleksioni: 394**

**Tirane më 28/03/2023**

**Ligjet referuese:**

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

[illegible]

A2023051737825756006

## PROKURË E PËRGJITHSHME

Sot, para meje Noteres VIOLETA V. SULKAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, LAGJJA NR.5, RR. SULEJMAN DELVINA, GODINA NR.29, APARTAMENTI NR. 92, HYRJA NR. 15, u paraqit personalisht:

**(I/E) PERFAQESUAR:**

- SHKODRA BETON-INERT"sh.p.k, me NIPT Nr. L72025009M, me qendër ne Tirane, ne adresën Tirane Kashar MEZEZ Autostrada Tirane-Durres km 0, ish-Serrat, Mezez, perfaqesuar nga Ortakja dhe Administratorja e vetme e saj, **Znj. Mukadez Gjini** e bija e Vehbi dhe Olimbi, e dtl 04-08-1960, lindur ne Shkoder, banues ne Shkoder, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, statusi e veje, identifikuar nepermjet leternjoftimit elektronik me numer personal G05804067U ne cilesine e ortakes se vetme dhe administratores se shoqerise .

E cila me dëshirë të lirë, vullnet të plotë dhe të pa vesuar, kërkoi nga unë Noterja hartimin e kësaj prokure të përgjithshme në bazë të neneve nr. 64, 71 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, nenit 62, pika 1, germa "ll", neni 63, pika 1, germa "ç", neni 99 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", si më poshtë vijon:

Porositesja e mesiperme, Znj. Mukadez Gjini e bija e Vehbi dhe Olimbi, e dtl 04-08-1960, lindur ne Shkoder, banues ne Shkoder, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, statusi e veje, identifikuar nepermjet leternjoftimit elektronik me numer personal G05804067U ne cilesine e ortakes se vetme dhe administratores se shoqerise SHKODRA BETON-INERT"sh.p.k, me NIPT Nr. L72025009M, me qendër ne Tirane, ne adresën Tirane Kashar MEZEZ Autostrada Tirane-Durres km 0, ish-Serrat, Mezez deklaron se emeron perfaqesues te saj te pergjithshem te quajturit :

1. ***Kreshnik Cupi*** i biri i Nazir-it dhe i Sanie, lindur me 22.09.1984, në Arrnollë, Dibër e banues në Tiranë, Rruga "Donje"-Tirane, banesë private, kombësia dhe shtetesia Shqipetare, statusi i martuar, i seksit mashkull, madhor, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, identifikuar nëpërmjet pasaportes me nr personal I40922030J

2. ***Leonard Sulaj*** i biri i Reis, lindur me 16-04-1969, në Kuc, e banues në Tiranë, Rezidenc – Lonk Hill- Petrele-Tirane, kombësia dhe shtetesia Shqipetare, statusi i martuar, i seksit mashkull, madhor, me zotesi të plotë juridike e për të vepruar, i identifikuar nëpërmjet leternjofimit me nr G90416175F

te cileve u jep tager dhe kompetence te plote qe te veproj ne emer e per llogari te perfaqesuarit te mesiperm per t'a perfaqesuar si me poshte vijon :

1. Perfaqesuesit kane te drejte qofte bashkarisht apo vec e vec te paraqiten prane te gjitha institucioneve shteterore dhe joshteterore, institucioneve administrative te pushtetit qendror e vendor publik, organeve publike,private,zyra permbarimi, noterie, ndermjetesimi, apo cdo zyre tjeter te parashikuar me ligj, akte nenligjore (Bashki, Gjendje civile, ZRPP, Arshive, Banke, institucione qendrore e vendore, Tatim taksa, OSSHE, UKT, QKB, gjykata te cdo niveli, Sigurime shoqerore etj .. pra cdo institucioni tjeter shteterore, qendror, vendor, departament, drejtori te cituar apo jo ne kete prokure, ne emer dhe per llogari te shoqerise) apo institucioni privat te regjistruar sipas legjislacionit shqiptar, per kryerjen e cdo veprimi te parashikuar në ligj, terheqje dokumentash e nenshkrim, aplikim, kerkim te cdo lloj dokumenti, depozitim, terheqje praktikash, realizim pagesash apo kryerjen e cdo veprimi te

parashikuar ne ligj, ne emer dhe per llogari te shoqerise, qe lidhet me mbarevajtjen e veprimtarise se shoqerise "SHKODRA BETON-INERT"sh.p.k, kundrejt te treteve, apo realizimin e cdo lloj dokumenti te nevojshem qe lidhet me porositesin e mesiperm si perfaqesues ligjor i shoqerise.

2. Perfaqesuesit kane te drejte qofte bashkarisht apo vec e vec te paraqiten prane cdo institucioni publik, shteterore, joshteteror, privat,zyra permbarimi, noterie, ndermjetesimi, apo cdo zyre tjeter te parashikuar me ligj, akte nenligjore, ne menyre qe te nenshkruaj cdo lloj akti apo veprimi noterial duke perfshire nenshkrimin e cdo lloj kontrate te parashikuar nga legjislacioni shqiptar, qofte kontrate shitblerje, kontrate dhurimi, kontrate qiraje, huaje,kredie, kontrata porosie,kontrate hipotekimi, furnizimi, deklarata noteriale, huaje, huaperdorje , akt marreveshje, etj... te gjitha kontratat, marreveshjet, aktet noteriale, qe njihen nga Kodi Civil I Republikes se Shqiperise si per pasurite e luajtesshme ashtu edhe per pasurite e paluajtesshme, kredite bankare, veprime bankare me te tretet, qe lidhen me aktivitetin e shoqerise ne emer dhe per llogari te shoqerise, qe lidhet me mbarevajtjen e veprimtarise se shoqerise "SHKODRA BETON-INERT"sh.p.k, kundrejt te treteve, apo realizimin e cdo lloj dokumenti te nevojshem qe lidhet me porositesin e mesiperm si perfaqesues ligjor i shoqerise.

3. Perfaqesuesit kane te drejte qofte bashkarisht apo vec e vec, te tjetersoje, shese tek te tretet te caktoje cmimet, te gjeje subjektet kontraktore, te vjele te hollat qe rrjedhin nga keto kontrata si dhe te paguaje te gjitha detyrimet qe njihen me ligj per pasurite e paluajtesshme dhe te luajtesshme qe zoteroj si ortak dhe administrator i shoqerise "SHKODRA BETON-INERT"sh.p.k, ka te drejte te terheqe te hollat qe rrjedhin nga shitja e pasurive te paluajtesshme dhe te luajtesshme apo cdo veprimi tjeter kontraktual qe lidhet me shoqerine kundrejt te treteve, apo realizimin e cdo lloj dokumenti te nevojshem qe lidhet me porositesin e mesiperm si perfaqesues ligjor i shoqerise.

4. Perfaqesuesit kane te drejte qofte bashkarisht apo vec e vec, te me perfaqesoje edhe ne cdo gjykate te vendit, si ne shkallen e pare civile, administrative, apo penale ,seksioni tregtar, ne ate te Apelit ( civil , administrativ ,penal, seksion tregtar) ne Gjykaten e Larte Tirane, Gjykaten Kushtetuese deri ne gjykaten e Strazburgut duke kryer cdo veprim te parashikuar nga ligji ne emer dhe per llogari te shoqerise gjer ne ekzekutimin e plote te vendimeve ne kuader te permbushjes se te drejtave dhe detyrimeve te Shoqerise qe une perfaqesoj.

5. Perfaqesuesit kane te drejte qofte bashkarisht apo vec e vec e berjes se kerkesave, kerkese padive, kerkesave ankimore, kunderpadive, rekurseve, shteseve prapsimeve, pezullimeve, ndryshimeve te objekteve te padive, marrjes pjese ne proceset gjyqesore si paditesa, te paditur, persona te interesuar, marrje pjese ne proces gjyqesor me pjesemarrje vullnetare apo te detyruar, ne cilesine e nderhyresit kryesor apo dytesor si dhe cdo lloj pozicioni subjekti procedural i parashikuar nga ligji, ku pozicionohet shoqeria, paraqitjen e cdo kerkese ne emer dhe per llogari te shoqerise, vazhdimin e gjykimeve, ankimeve, pezullimeve,pushimeve te gjykimit te ceshtjeve te ndryshme civile, kundershtim veprimesh permbarimore dhe cdo lloj kerkese procedurale ligjore te parashikuar ne ligj, qe lidhen me mbrojtjen e interesave pasurore te Shoqerise, duke perfshire cdo lloj objekt gjykimi civile, administrativ, tregtar, penal, si dhe te ekzekutimit te vendimeve gjyqesore te dhena ne interes te porositesit, caktimit te avokateve, revokimit te tyre, eksperteve dhe kundershtimit te tyre perjashtimit te gjyqtarit apo anetareve te trupit gjykues kundershtimit te vendimeve gjyqesore dhe atyre te ndermjetme qe ligji e lejon si dhe ka te drejten e disponimit mbi objektin e padise dhe te shkakut ligjor, te therrase pale ne gjykime, te beje konkluzione dhe kerkime perfundimtare, kerkoj pushim gjykimesh, procediesh, te drejtohet tek ndremjetesi e te zgjidhe ceshtje me ndermjetesi, pavlefshmeri titujsh ekzekutiv apo cdo kerkese tjeter gjyqesore civile, penale, administrative, tregtare, ekzekutive, ndermjetesimi, si dhe cdo te drejte tjeter qe ai cmon ne interes te saj, duke i dhene tagra te plote sic parashikohen ne ligj, lidhur me procedimet ku shoqeria eshte subjekt i se drejtes se parashikuar ne ligj, duke ushtruar te gjitha te drejtat

në kuader te mbrojtjes se interesave ligjore te saj, etj...Perfaqesuesit kane te drejte qofte bashkarisht apo vec e vec qe nga pozicioni I nderhyresit kryesor, apo cdo lloj pozicioni procedural te parashikuar ne ligj te hartoje dhe nenshkruaje kerkese, padi, parashtrime, kerkesa per cdo lloj prove, akte, fatura, nenprokura, autorizime, cdo lloj akti, shkrese, kontrate, marrveshje, veprime bankare, si brenda prane te gjitha organeve shteterore publike, jo publike, private si dhe organet e varesise, qe I rezervohet te perfaqesuarit- Shoqerise "SHKODRA BETON-INERT"sh.p.k .

6. Perfaqesuesit kane te drejte qofte bashkarisht apo vec e vec te drejte te veprojne edhe prane Bankave te cdo niveli qofshin ato per të kryer cdo lloj veprimi financiar te parashikuar ne ligj, si terheqje depozitim transferte, ngurtesim celjes nr llogarie ne leke ose ne valute, etj apo cdo veprim tjeter te nevojshem, domosdoshem, dhe te lejuar me ligj parashikuar nga legjislacioni Bankar ne emer dhe per llogari te shoqerise .
7. Po keshtu Perfaqesuesit kane te drejte qofte bashkarisht apo vec e vec te drejten e caktimit te ndonje personi te trete apo avokat ka te drejten e berjes se nenprokures me te tjere, duke ja deleguar kompetencat plotesisht apo pjeserisht si ta vleresoje vete perfaqesuesi i mesiperm.

Kjo prokure behet me afat 5 (pese) vjecar , afat i cili fillon me nenshkrimin e ketij akti .

E/I përfaqësuara/i deklaroi se: *"Të gjitha veprimet e kryera nga perfaqësuesit e im te përgjithshëm brenda tagrave të përcaktuara në këtë prokurë, në mbështetje të të drejtave që më njeh legjislacioni në fuqi në shtetin Shqiptar, do t'i konsideroj të drejta e të mirëqena, sikur të ishin kryer prej vetë meje"*. Prokura e Përgjithshme, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të të përfaqësuarës, e cila e kuptoi përmbajtjen e saj dhe meqenëse shpreh vullnetin e saj të lirë e të plotë, u njoh dhe i kuptoi efektet e saj juridike, e nënshkroi atë rregullisht përpara meje Noteres. Kjo Prokurë e Përgjithshme u hartua në gjuhën Shqipe prej meje Noteres në 4 (katër) kopje, me vlera të njëjta juridike, mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të të përfaqësuarës. Njëra kopje vendoset në arshivën noteriale, kopjet e tjerë për të përfaqësuarin.

Unë Noterja, verifikova identitetin e të përfaqësuarës nëpërmjet dokumentit të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", neni 62, neni 63 dhe neni 99 i tij; vërtetoj nënshkrimin e saj.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", me ndryshimet; Unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të kësaj prokure, në mënyrë te drejtë dhe të ligjshme.

**(I/E) PERFAQESUAR**
**Shoqeria" SHKODRA BETON-INERT"sh.p.k**
**Perfaqesuar nga Administratore dhe Ortake e vetme**
**MUKADEZ GJINI**

Mukadez

NUIS L71025009M SHKODRA BETON Inert sh.p.k. Tirana - Albania

**NOTERE**
**VIOLETA SULKAJ**

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | |
|---|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | M11327009B | |
| 2. Data e Regjistrimit | 27/01/2021 | |
| 3. Emri i Subjektit | THURJE | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 22/01/2021 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 22/01/2021 | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Tirane DRITAS Nr.Pasurie 665/14, Nr.Pasurie 665/6, Zone kadastrale 1549 | |
| 8. Kapitali | 100.000,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 1,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Transportimin, perpunim dhe riciklim te materialeve inerte, si: rera, zhavorre, gure, çakull, gelqere, granile etj, dhe materialeve te ndryshme per ndertim. Transport mallrash te te gjitha llojeve per vete dhe per te trete, personash brenda dhe jashte vendit. Shitje dhe blerje automjetesh te gjitha llojeve dhe riparimi i tyre. Sherbime gomisterie, shitje goma te madhesisve te ndryshme dhe bateri. etj. Transportimin e mineraleve te ndryshme, tregti me shumice dhe pakice e mineraleve te ndryshme dhe materialeve inerte per ndertim. Grumbullim, transport, magazinim, ruajtje dhe riciklim/rukuperim i mbetjeve inerte jot e rrezikshme.Prodhim i Betonit i asfaltobetonit. Fraksionimi dhe prodhimi I produkteve mineraleve jometalike. Mjete me qera. | |
| 10. Administratori/ët | Esat Demiri | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 22/01/2021 | Deri: 13/05/2027 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Ortakët | EsatDemiri | |
| 12.1 Vlera e kapitalit | Para: 100.000,00 | Natyre: |
| 12.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 100,00 | |

Kopje nga web

| | |
|---|---|
| *- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | |
| 13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | |
| 14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: THURJE<br>Web site: www.thurje.com<br>E-Mail: kontabiliteties@hotmail.com<br>Telefon: 0695520677 |
| 15. Statusi: | Aktiv |

Datë: 07/08/2024

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga web

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | |
|---|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | L72025009M | |
| 2. Data e Regjistrimit | 25/08/2017 | |
| 3. Emri i Subjektit | SHKODRA BETON-INERT | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 17/08/2017 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 17/08/2017 | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Kashar MEZEZ Autostrada Tirane-Durres km 0, ish-Serrat, Mezez | |
| 8. Kapitali | 100.000,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 1,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Prodhim betoni dhe materiale inerte. Prodhim tregtim me shumice dhe pakice materiale ndertimi. Zbatimit te punimeve te ndertimit si; Ndertime civile dhe ekonomike, veshje fasadash, rikonstruksion godinash etj. Punime dheu, sistemime, terracime sistemesh, vepra kullimi e vaditjesh etj. Ndertim rruge kategoria e IV, V, veshje rrugesh me asfaltobeton, nderrim mbishtrese etj. Ndertim vepra arti te vogla deri ne 6 metra; ujesjellesa, kanalizime etj. Prodhim dhe tregtim materialesh ndertimi. Tregtim me pakice e shumice dhe import – eksport te, mallrave te ndryshme industriale, ushqimore, hidrosanitare, hidraulike etj.Makineri-pajisje industriale e bujqesore, pjese kembimi te ndryshme etj. Shitje, import eksport hekuri. Transport i mallrave te ndryshme brenda e jashte vendit. Sherbime Bar Kafe, restorant. Parking, marrje, dhënie me qera të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme. | |
| 10. Administratori/ët | Mukadez Gjini | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 19/02/2021 | Deri: 19/02/2026 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

| | | |
|---|---|---|
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Eksperti/ët Kontabël (nëse ka) | Ardiola Huta | |
| 12.1 Afati i emërimit | Nga: 01/05/2023 | Deri: 01/05/2026 |
| 13. Ortakët | MukadezGjini | |
| 13.1 Vlera e kapitalit | Para: 100.000,00 | Natyre: |
| 13.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 100,00 | |
| **Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)* | | |
| 13.4 Komente (nëse ka) | | |
| 14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | | |
| 15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: SHKODRA BETON – INERT<br>E-Mail: info@shkodrabeton.com<br>Telefon: +355694025855 | |
| 16. Statusi: | Aktiv | |

Datë: 07/08/2024

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2024/08/07 11:02:25 +02:00
L72025009M2024080711021667
2006

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | |
|---|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | L72025009M | |
| 2. Data e Regjistrimit | 25/08/2017 | |
| 3. Emri i Subjektit | SHKODRA BETON-INERT | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 17/08/2017 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 17/08/2017 | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Kashar MEZEZ Autostrada Tirane-Durres km 0, ish-Serrat, Mezez | |
| 8. Kapitali | 100.000,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 1,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Prodhim betoni dhe materiale inerte. Prodhim tregtim me shumice dhe pakice materiale ndertimi. Zbatimit te punimeve te ndertimit si; Ndertime civile dhe ekonomike, veshje fasadash, rikonstruksion godinash etj. Punime dheu, sistemime, terracime sistemesh, vepra kullimi e vaditjesh etj. Ndertim rruge kategoria e IV, V, veshje rrugesh me asfaltobeton, nderrim mbishtrese etj. Ndertim vepra arti te vogla deri ne 6 metra; ujesjellesa, kanalizime etj. Prodhim dhe tregtim materialesh ndertimi. Tregtim me pakice e shumice dhe import – eksport te, mallrave te ndryshme industriale, ushqimore, hidrosanitare, hidraulike etj.Makineri-pajisje industriale e bujqesore, pjese kembimi te ndryshme etj. Shitje, import eksport hekuri. Transport i mallrave te ndryshme brenda e jashte vendit. Sherbime Bar Kafe, restorant. Parking, marrje, dhënie me qera të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme. | |
| 10. Administratori/ët | Mukadez Gjini | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 19/02/2021 | Deri: 19/02/2026 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

| | | |
|---|---|---|
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Eksperti/ët Kontabël (nëse ka) | Ardiola Huta | |
| 12.1 Afati i emërimit | Nga: 01/05/2023 | Deri: 01/05/2026 |
| 13. Ortakët | MukadezGjini | |
| 13.1 Vlera e kapitalit | Para: 100.000,00 | Natyre: |
| 13.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 100,00 | |
| *Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)* | | |
| 13.4 Komente (nëse ka) | | |
| 14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | | |
| 15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: SHKODRA BETON – INERT<br>E-Mail: info@shkodrabeton.com<br>Telefon: +355694025855 | |
| 16. Statusi: | Aktiv | |

Datë: 26/08/2024

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2024/08/26 18:44:22 +02:00
L72025009M20240826184414142006

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | |
|---|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | M11327009B | |
| 2. Data e Regjistrimit | 27/01/2021 | |
| 3. Emri i Subjektit | THURJE | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 22/01/2021 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 22/01/2021 | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Tirane DRITAS Nr.Pasurie 665/14, Nr.Pasurie 665/6, Zone kadastrale 1549 | |
| 8. Kapitali | 100.000,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 1,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Transportimin, perpunim dhe riciklim te materialeve inerte, si: rera, zhavorre, gure, çakull, gelqere, granile etj, dhe materialeve te ndryshme per ndertim. Transport mallrash te te gjitha llojeve per vete dhe per te trete, personash brenda dhe jashte vendit. Shitje dhe blerje automjetesh te gjitha llojeve dhe riparimi i tyre. Sherbime gomisterie, shitje goma te madhesisve te ndryshme dhe bateri. etj. Transportimin e mineraleve te ndryshme, tregti me shumice dhe pakice e mineraleve te ndryshme dhe materialeve inerte per ndertim. Grumbullim, transport, magazinim, ruajtje dhe riciklim/rukuperim i mbetjeve inerte jot e rrezikshme.Prodhim i Betonit i asfaltobetonit. Fraksionimi dhe prodhimi I produkteve mineraleve jometalike. Mjete me qera. | |
| 10. Administratori/ët | Esat Demiri | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 22/01/2021 | Deri: 13/05/2027 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

| | | |
|---|---|---|
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Ortakët | EsatDemiri | |
| 12.1 Vlera e kapitalit | Para: 100.000,00 | Natyre: |
| 12.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 100,00 | |
| ***Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)** | | |
| 12.4 Komente (nëse ka) | | |
| 13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | | |
| 14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: THURJE<br>Web site: www.thurje.com<br>E-Mail: kontabiliteties@hotmail.com<br>Telefon: 0695520677 | |
| 15. Statusi: | Aktiv | |

Datë: 26/08/2024

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2024/08/26 18:43:50 +02:00
M11327009B2024082618434237
2006

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)